1. Ora është tre e njëzet minuta. 2. Ora është katër e dyzet minuta. Ora është pesë pa njëzet. 3. Ora është shtatë e tridhjetë minuta. Ora është shtatë e gjysmë. 4. Ora është tetë e pesëdhjetë minuta. Ora është nëntë pa dhjetë. 5. Ora është dhjetë e dyzet e pesë minuta. Ora është njëmbëdhjetë pa një çerek. Ora është njëmbëdhjetë pa pesëmbëdhjetë minuta. 6. Ora është njëmbëdhjetë e dhjetë minuta. 7. Ora është nëntë e njëzet e pesë minuta. 8. Ora është dy e tridhjetë e pesë minuta. Ora është tre pa njëzet e pesë. 9. Ora është pesë e pesëmbëdhjetë minuta. Ora është pesë e një çerek. 10. Ora është gjashtë e pesë minuta. 11. Ora është një e pesëdhjetë e pesë minuta. Ora është dy pa pesë. 12. Ora është dhjetë.

Ushtrimi 2.9

1. Paola është nga Italia. 2. Jo, Pjeri dhe Ava nuk janë nga Spanja. 3. Ata janë nga Franca. 4. Jo, ata nuk flasin italisht. 5. Ava flet pak spanjisht. 6. Po, Paola flet pak frëngjisht. 7. Pjeri dhe Ava flasin frëngjisht, sepse janë francezë. 8. Besa flet shqip, sepse është shqiptare. 9. Jo, Besa nuk flet italisht. 10. Ora është katër e një çerek.

Ushtrimi 2.10

1. Je ti nga Shqipëria? Jeni ju nga Shqipëria? 2. A flet frëngjisht? A flisni ju frëngjisht? 3. Nga është zonja Paola? 4. Nga është ajo? 5. Çfarë gjuhe flasin Pjeri dhe Ava? 6. Çfarë gjuhe flisni ju? 7. Flisni ju rumanisht? 8. Flasin ata anglisht? 9. Po, jemi ju nga Kina? 10. Nga jeni ju? 11. Sa është ora tani?

Mësimi 3

Ushtrimi 3.1

	Nga është?	Ku banon?	A ka fëmijë?	Si quhet vajza/djali?	Sa vjeç(e) është vajza/djali?
Paola	nga Roma	në Romë	Ka një vajzë.	Vajza quhet Maria.	Vajza është 10 vjeçe.
Pjeri	nga Lioni	në Paris	Ka një djalë.	Djali quhet Eduard.	Djali është 12 vjeç.
Drini	nga Tirana	në Sarandë	Jo. Nuk ka fëmijë.		

Ushtrimi 3.2

1. Kush është nga Italia? 2. Nga janë zonja Paola dhe zoti Marko? 3. Çfarë bën zonja Paola në Shqipëri? 4. Është zoti Pjer nga Parisi? 5. Ku banon ai? 6. A banon Drini në Sarandë. 7. A po mëson zoti Pjer shqip në

Shqipëri? 8. Ku mëson shqip zoti Pjer? 9. A po punojnë zonja Paola dhe zoti Marko në Shqipëri? 10. Ku banojnë zonja Paola dhe zoti Marko? 11. Sa vjeçe është Maria? 12. Është Eduardi 10 vjeç?

Ushtrimi 3.3

	banoj	flas	punoj	jam
unë	banoj	flas	punoj	jam
ti	banon	flet	punon	je
ai, ajo	banon	flet	punon	është
ne	banojmë	flasim	punojmë	jemi
ju	banoni	flisni	punoni	jeni
ata, ato	banojnë	flasin	punojnë	janë

Ushtrimi 3.4

Paola është italiane, është nga Roma. Ajo banon në Romë, por tani është në Shqipëri me pushime. Ajo flet italisht dhe pak shqip. Është e martuar dhe ka një vajzë. Ajo është dhjetë vjeçe. Pjeri është francez; është nga Franca. Ai banon në Paris, por nuk është nga Parisi. Tani është në Shqipëri dhe po mëson shqip në universitet. Pjeri flet frëngjisht, anglisht dhe pak shqip. Edhe Pjeri është i martuar. Ai ka një djalë. Ai është dymbëdhjetë vjeç. Drini është shqiptar. Ai është nga Tirana, por nuk banon në Tiranë. Ai banon në Sarandë. Ai nuk është i martuar. Ai është beqar.

Ushtrimi 3.5

1. Melita flet greqisht. Ajo banon në Greqi. 2. Ahmeti flet turqisht. Ai punon në Turqi. 3. Pjeri dhe Ava janë nga Parisi. Ata banojnë në Francë. 4. Ju jeni nga Londra. Ju punoni në Angli. 5. Maria është nga Roma. Ajo banon në Itali. 6. Helga është nga Berlioni. Ajo punon në Gjermani. 7. Djali flet suedisht. Ai punon në Suedi. 8. Ne flasim bullgarisht. Ne banojmë në Bullgari. 9. Ana flet sllovenisht. Ajo punon në Slloveni. 10. Unë jam nga Madridi. Unë banoj në Spanjë.

Ushtrimi 3.6

1. Ne flasim shqip dhe banojmë në Shqipëri. 2. Ahmeti dhe Manjola punojnë në Meksikë. 3. Ata flasin kinezisht dhe banojnë në Kinë. 4. Unë mësoj shqip. 5. Ti mëson armenisht dhe punon në Armeni. 6. Ata banojnë në Holandë dhe flasin holandisht. 7. Ne flasim frëngjisht dhe banojmë në Zvicër. 8. Ti punon në Athinë. 9. Ai banon në Poloni. 10. Ajo punon në Rusi dhe mëson rusisht.

Ushtrimi 3.8

1. Nga po vjen Drilona? 2. Ku po shkon Drilona? 3. Me se shkoni në kopsht? 4. Ç'bën Drilona në mbrëmje? 5. Po vajza ç'bën në mbrëmje? 6. Sa fëmijë ka Sokoli? 7. A shkon Drilona në shtëpi më këmbë? 8. A shkojnë fëmijët në shkollë? 9. Si vjen vajza nga kopshti? 10. Ku po shkon Gëzimi? 11. A shkon te Sokoli me autobus? 12. Sa vjeçe është vajza? 13. A është djali 8 vjeç?

Ushtrimi 3.9

Drilona dhe Gëzimi janë nga Durrësi, por tani po banojnë dhe po punojnë në Tiranë. Sokoli është në shtëpi. Drilona po vjen nga Sokoli dhe po shkon në punë. Gëzimi vjen nga shtëpia dhe po shkon te Sokoli. Gëzimi po shkon në shtëpi më këmbë, kurse Drilona po shkon me autobus. Sokoli ka dy fëmijë. Vajza është 8 vjeçe, kurse djali është 10 vjeç. Ata shkojnë në shkollë. Gëzimi ka vetëm një vajzë. Vajza shkon në kopsht. Pasdite, Drilona lexon, shikon televizor ose gatuan, kurse vajza luan.

Ushtrimi 3.13

1. Nga është Skënderi? 2. Ku banon ai? 3. Si flet ai anglisht? 4. Kur mbaron puna? 5. Çfarë është Ema? 6. Kur fillon puna në spital? 7. Sa fëmijë kanë ata? 8. Si flet Skënderi frëngjisht? 9. Çfarë bën vajza në mbrëmje? 10. Po djali, çfarë bën?

Ushtrimi 3.15

Ai është Skënderi. Skënderi është nga Shqipëria, nga Vlora, por tani banon në Tiranë. Skënderi është mjek dhe punon në një spital në Tiranë. Skënderi është i martuar. Gruaja e tij quhet Ema. Ajo është mësuese dhe punon në një shkollë në Tiranë. Skënderi punon shumë, sepse puna në spital fillon herët në mëngjes dhe mbaron pasdite vonë.

Ushtrimi 3.16

	jam	kam	vij	këndoj	bëj	luaj
ti	je	ke	vjen	këndon	bën	luan
ju	jeni	keni	vini	këndoni	bëni	luani
ai, ajo	është	ka	vjen	këndon	bën	luan
ata, ato	janë	kanë	vijnë	këndojnë	bëjnë	luajnë
unë	jam	kam	vij	këndoj	bëj	luaj
ne	jemi	kemi	vijmë	këndojmë	bëjmë	luajmë

Mësimi 4

Ushtrimi 4.1

1. Ai është mjek dhe punon në spital. Alma është mjekë dhe punon në ambulancë. Ne jemi mjekë dhe punojmë në Tiranë. Doruntina dhe Adea janë mjekë. Doruntina, Adea dhe unë punojmë këtu. 2. Këta janë Pjeri dhe Ana. Çfarë kombësie dhe çfarë profesioni kanë ata? Pjeri është francez, por tani jeton në Shqipëri. Është dentist dhe punon në një klinikë në Tiranë. Gruaja e tij, Ana, është franceze. Edhe ajo është dentiste dhe punon në një laborator në Tiranë. Pjeri dhe Ana janë francezë dhe punojnë si dentistë në Tiranë. 3. Elena dhe Johani vijnë nga Gjermania. Janë burrë e grua. Janë gjermanë, por tani jetojnë në Shqipëri. Burri i saj, Johani, nuk është mësues. Nuk punon në Korçë. Ai punon në Tiranë, por shkon në Korçë çdo fundjavë.

Ushtrimi 4.2

1. Çfarë është Alma? Ku punon ajo? 2. Çfarë janë Beni dhe Elda? Ku punojnë ata? 3. Çfarë kombësie kanë Pjeri dhe Ava? A jetojnë ata në Francë? Ku jetojnë ata? 4. A janë Tomi dhe Stefania ekonomistë? Ku banojnë ata? 5. Elida dhe Dorina janë mësuese? Ku punojnë ato? 6. Nga vijnë Johani dhe Elena? Çfarë profesioni ka gruaja? Po burri? 7. Pse shkon Johani në Korçë çdo fundjavë? 8. A punojnë Bledi dhe Bora çdo ditë?

Ushtrimi 4.3

1. Ky është Agimi. Ai është student në universitet. 2. Kjo është Fatbardha. Ajo është mësuese në një shkollë në Tiranë. 3. Ç'kombësi kanë ata aktorë? Ata aktorë janë kosovarë, por këta janë italianë. 4. Kjo studente është shqiptare, por flet anglisht shumë mirë. 5. Këto studente janë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Janë amerikane, por studiojnë në universitet në Tiranë. Flasin shqip lirisht. 6. Ata burra janë mjekë. Punojnë në spital. 7. Këto gra janë mësuese. Janë franceze, por tani po punojnë në Shqipëri. 8. Ai burrë është ekonomist. Vjen nga Anglia, por tani nuk jeton në Angli; jeton dhe punon në Kosovë. 9. Ata aktorë janë francezë. Këndojnë dhe kërcëjnë çdo fundjavë në teatër. 10. Ky muzikant vjen nga Lisbona. Punon këtu të shtunën dhe të dielën.

Ushtrimi 4.5

1. Pardje ishte e hënë, sot është e mërkurë dhe nesër është e enjte. Dje ishte e martë. 2. Sokoli nuk punon të shtunën. Punon vetëm nga e hëna deri të premten. 3. Unë nuk shkoj në universitet të mërkurën dhe të premten. Shkoj vetëm të hënë, të martën dhe të enjten. 4. Bledi dhe Bora nuk punojnë shumë. Punojnë vetëm të premten dhe të shtunën. Nga e hëna deri të enjten ato shkojnë në universitet. Të dielën pushojnë.

Ushtrimi 4.6

Mira dhe Agimi tani bëjnë shëtitje në qytet. Ata gjejnë një kafene dhe hyjnë brenda. Agimi do një birrë, kurse Mira do një kafe dhe një gotë ujë. Gjergji është mjek. Ai punon në spital dhe jep mësim në universitet. Është 48 vjeç. Teuta është gazetare dhe punon në një gazetë në Tiranë. Ajo është 41 vjeçe edhe është e re dhe e bukur. Mira ka një motër dhe një vëlla. Motra quhet Brikena dhe është studente në universitet, por në fundjavë punon. Albani është student. Shkon në universitet nga e hëna deri të premten.

Ushtrimi 4.7

1. Në ç'orë shkon ti në punë? Unë shkoj në orën shtatë. Punoj nga ora tetë deri në orën pesë. Shkon ti çdo ditë me autobus? Po, unë shkoj me autobus. 2. Çfarë profesioni ke ti? Po gruaja jote? Gruaja ime është mësuese. Ajo jep mësim në një shkollë, në Tiranë, kurse unë jap mësim në universitet. Çfarë jepni ju? Japim frëngjisht. 3. Unë kam një vëlla dhe një motër. Vëllai im është 15 vjeç. Ai këndon dhe kërcen shumë mirë. Në fundjavë ai studion pak, shikon televizor, luan futboll dhe pushon në shtëpi. Motra ime është 20 vjeçe. Ajo studion në universitet. Ajo flet dhe shkruan anglisht dhe frëngjisht shumë mirë. Në fundjavë punon si sekretare për një firmë angleze.

Ushtrimi 4.8

1. Ata artistë jetojnë në Paris. 2. Ato janë gazetare. 3. Ata janë mësues dhe vijnë në shkollë në orën tetë. 4. Ne shkojmë në kinema me disa artiste. 5. Këta avokatë janë shqiptarë. 6. Këto gazetare janë spanjolle. 7. Ju vini në shtëpi me disa mësues në orën shtatë. 8. Këto kuzhinieri kineze zakonisht shkojnë në punë në orën pesë. 9. Këta këngëtarë këndojnë disa këngë. 10. Ato mësuese shkojnë në klasë dhe shpjegojnë mirë.

Ushtrimi 4.9

	jam	kam	pushoj	bëj	shkruaj	vij
unë	jam	kam	pushoj	bëj	shkruaj	vij
ne	jemi	kemi	pushojmë	bëjmë	shkruajmë	vijmë
ti	je	ke	pushon	bën	shkruan	vjen
ju	jeni	keni	pushoni	bëni	shkruani	vini
ai, ajo	është	ka	pushon	bën	shkruan	vjen
ata, ato	janë	kanë	pushojnë	bëjnë	shkruajnë	vijnë

	flas	jap	dua	them
unë	flas	jap	dua	them
ne	flasim	japim	duam	themi
ti	flet	jep	do	thua
ju	flisni	jepni	doni	thoni
ai, ajo	flet	jep	do	thotë
ata, ato	flasin	japin	duan	thonë

Ushtrimi 4.10

1. Ku jeton Agroni? 2. Ç'kombësi ka babai i tij? 3. Është nëna e tij shqiptare? 4. Sa vjeç është Agroni? 5. Pse nuk flasin shqip në shtëpi? 6. Ku jeton Agroni? 7. Ç'bën Agroni në bibliotekë? 8. Shkon ai çdo ditë në universitet? 9. Kur shkon në kinema ose në diskotekë? 10. Ç'profesion ka Bora? Ku punon ajo?

Mësimi 5

Ushtrimi 5.1

1. Ku janë Era dhe nëna e saj? 2. Çfarë po bën nëna? 3. Kush është Arbi? 4. Në ç'orë fillon takimi? 5. A është e martuar Jonida? 6. A është beqar Kastrioti? 7. Pse është babai tek mjeku? 8. Në ç'orë fillon puna? 9. Ç'po bën gjyshi? 10. Ç'po bën gjyshja? 11. A janë gjyshi dhe gjyshja në shtëpi? 12. Ku është papagalli? 13. Ku është macja? 14. A është qeni nën kolltuk?

Ushtrimi 5.2

1. Çfarë është ky? Është një zog. Ku është zogu? Zogu është djathtas. 2. Çfarë është ky? Është një student. Ku është studenti. Studenti është në universitet. 3. Çfarë është ky? Është një peshk. Ku është peshku? Peshku është në frigorifer. 4. Çfarë është ky? Është një divan. Ku është divani? Divani është në dhomë. 5. Çfarë është ky? Është një laps. Ku është lapsi? Lapsi është mbi tryezë. 6. Çfarë është kjo? Është një shtëpi. Ku është shtëpia? Shtëpia është afër. 7. Çfarë është ky? Është një frigorifer. Ku është frigoriferi? Frigoriferi është në kuzhinë. 8. Çfarë është kjo? Është një vajzë. Ku është vajza? Vajza është në shkollë. 9. Çfarë është ky? Është një televizor. Ku është televizori? Televizori është në dyqan. 10. Çfarë është kjo? Është një shkollë. Ku është shkolla? Shkolla është afër. 11. Çfarë është ky? Ky është shah. Ku është shahu? Shahu është mbi tryezë. 12. Çfarë është kjo? Kjo është studente. Ku është studentja? Studentja është në universitet. 13. Çfarë është ky? Ky është çelës. Ku është çelësi? Çelësi është mbi tryezë. 14. Çfarë është ky? Ky është flamur. Ku është flamuri? Flamuri është jashtë. 15. Çfarë është ky? Ky është mësues. Ku është mësuesi? Mësuesi është në shkollë. 16. Çfarë është ky? Ky është libër. Ku është libri? Libri është në shtëpi. 17. Çfarë është kjo? Kjo është karrige. Ku është karrigia? Karrigia është në dhomë. 18. Çfarë është kjo? Kjo është kuti. Ku është kutia? Kutia është në sirtar. 19. Çfarë është kjo? Kjo është tryezë. Ku është tryeza? Tryeza është në kopsht. 20. Çfarë është kjo? Kjo është lugë. Ku është luga? Luga është mbi tryezë.

Ushtrimi 5.3

1. Çfarë është ky? Ky është një pirun. Ku është piruni? Piruni është mbi tryezë. 2. Çfarë është kjo? Kjo është një lule. Ku është lulja? Lulja është në vazo. 3. Çfarë është kjo? Kjo është një makinë. Ku është makina? Makina është në garazh. 4. Çfarë është ky? Ky është një libër. Ku është libri? Libri është mbi tryezë. 5. Çfarë është ky? Ky është një mjek. Ku është mjeku? Mjeku është në spital. 6. Çfarë është ky? Ky është një divan. Ku është divani? Divani është në shtëpi. 7. Çfarë është ky? Ky është një çelës. Ku është çelësi? Çelësi është këtu. 8. Çfarë është kjo? Kjo është një gotë. Ku është gota? Gota është në kuzhinë. 9. Çfarë është kjo? Kjo është një pemë. Ku është pema? Pema është në oborr. 10. Çfarë është kjo? Kjo është një dritare. Ku është dritarja? Dritarja është atje.

Ushtrimi 5.4

1. Ç'bën zogu? Zogu këndon në pemë. Ku është pema? Është jashtë, në oborr. Ku është macja? Është nën pemë. 2. Ku është mësuesja tani? Mësuesja është në shkollë. Po nxënësi, ku është? Edhe nxënësi është në shkollë. 3. Çfarë është kjo? Kjo është një shtëpi. Si është shtëpia? Është e bukur. 4. Nëna ime është inxhinieri. Po nëna jote ku punon? Nëna ime është mjek. Punon në spital. Në ç'orë shkon në punë në mëngjes? Shkon në orën shtatë. Punon nga ora shtatë e gjysmë deri në orën pesë. 5. Çfarë bën babai yt? Babai im është ekonomist. Jeton në Shqipëri? Jo, jeton në Gjermani, në Mynih. Vjen shpesh nga Mynihu në Tiranë? Po.

Ushtrimi 5.5

Shëngjini është një qytet i vogël. Është shumë i këndshëm në pranverë dhe në verë, por i trishtuar në vjeshtë dhe në dimër. Në vjeshtë dhe në dimër qyteti është shumë i qetë dhe pa gjallëri. Koha nuk është e ftohtë, por bie shi dhe fryn erë. Qielli është shpesh gri dhe nganjëherë ka mjegull. Dimri është i butë dhe jo shumë i gjatë. Bie shi, por nuk bie kurrë borë. Koha në dimër nuk është e keqe. Vera në Tiranë është e nxehtë. Bën vapë dhe rrallë bie shi. Stina ime e preferuar/e parapëlqyer është pranvera. Koha në pranverë është e ngrohtë dhe natyra është shumë e bukur. Qielli është blu; dita është e gjatë; nata është e shkurtër dhe në rrugë ka shumë gjallëri. Në verë, dielli ndriçon, deti është blu dhe qyteti është plot jetë.

Ushtrimi 5.6

1. Djali është shqiptar, kurse vajza është e huaj. 2. Shkolla është e mbyllur të dielën. 3. Gjyshja është e lumtur, kurse gjyshi është i trishtuar. 4. Valixhja jote është e lehtë, kurse valixhja ime është shumë e rëndë. 5. Gëzimi është shumë i zgjuar, por vëllai i tij është pak budalla. 6. Besa është shumë e zgjuar, por motra e saj është pak budallaqe. 7. Tryeza nuk është e zezë, por e kaltër. 8. Libri i ri është këtu. Ku është revista e re? 9. Kjo vajzë është e vogël, kurse ajo vajzë është e madhe. 10. Motra ime nuk është vajzë e shëndetshme, është gjithmonë e sëmurë.

Ushtrimi 5.7

1. Ky libër është shumë i mirë. Ky libër është shumë i keq. 2. Libri është i lirë. Libri është i shtrenjtë. 3. Sot nuk jam e lirë. Sot nuk jam e zënë. 4. Koha është pak e nxehtë. Koha është pak e ftohtë. 5. Parku është i madh. Parku është i vogël. 6. Radioja është e zezë. Radioja është e bardhë. 7. Klienti është i kënaqur. Klienti është i pakënaqur. 8. Valixhja jote është pak e rëndë. Valixhja jote është pak e lehtë. 9. Ky mësim është i lehtë. Ky mësim është i vështirë. 10. Motra ime është e zënë sot. Motra ime është e lirë sot.

Ushtrimi 5.8

1. Kjo është biçikleta e madhe. Ku është biçikleta e vogël? 2. Hoteli i madh është larg, kurse hoteli i vogël është afër. 3. Vajza është e gjatë, kurse djali është i shkurtër. 4. Në dimër, dita është e shkurtër dhe nata është e gjatë. 5. Ky dyqan është i hapur, kurse ai atje është i mbyllur. 6. Kjo valixhe është e lehtë, ndërsa ajo atje është e rëndë. 7. Ky ushtrim është i lehtë, kurse ai është i vështirë. 8. Fletorja është e re. Edhe libri është i ri. 9. Apartamenti është i vogël. Edhe shtëpia është e vogël. 10. Vajza e vogël dhe djali i madh banojnë këtu.

Mësimi 6

Ushtrimi 6.1

1. Pamela është 20 vjeçe. 2. Pamela studion për matematikë në universitet. 3. Nuk ka bursë nga universiteti, prandaj punon. 4. Nuk jeton në shtëpi me prindërit, por jeton me dy shoqe në konvikt. 5. Këtë semestër ka katër lëndë. 6. Në shtëpi flet anglisht, sepse nëna e saj nuk flet shqip. 7. Çdo verë, Pamela kalon dy muaj në Shqipëri. 8. Babai i saj është dentist dhe punon në një klinikë dentare në Uashington. 9. Nëna e saj është pedagoge dhe jep letërsi në universitet. 10. Të shtunën në mëngjes vrapon ose noton.

Ushtrimi 6.2

1. Çfarë bën ti në fundjavë? Të shtunën notoj në pishinë dhe vrapoj. Të dielën kërcëj në diskotekë. 2. Ne këndojmë këngë shqiptare. 3. Këtu është kafeneja. A hyjmë brenda? 4. Porosia vjen menjëherë. 5. Ahmeti është nga Turqia, por studion në Shqipëri. 6. Ç' dëshironi ju? Dua një çaj dhe një kafe, ju lutem.

1. Unë nuk flas shqip. 2. Motra ime studion në universitet dhe banon në konvikt. 3. Ç' studioni ju në universitet? 4. Vëllai im luan futboll në fundjavë. 5. Ata notojnë në pishinë. 6. Kush gatuan në shtëpi? 7. Në ç' orë është takimi? 8. Ata janë në Sarandë me pushime. 9. Vëllai im tani mëson anglisht në shkollë. 10. Të shtunën (ne) nuk punojmë, por pushojmë.

1. Ku shkon tani? 2. Kur shikon televizor? 3. Pse shkon tek mjeku tani? 4. Elena dhe Filipi nuk janë shqiptarë. Janë spanjollë. 5. Ç'bëni tani? Lexojmë. 6. Unë jam Marta. Punoj në teatër.

1. Nëna ime është mjeke. Punon në ambulancë. 2. Beni është inxhinier. Punon në fabrikë. 3. Pjeri është dentist. Zakonisht vjen nga klinika në orën shtatë. 4. Elena është mësuese. Shpesh shkon në shkollë më këmbë. 5. Ato janë aktore dhe punojnë në teatër në fundjavë. 6. Këta futbollistë luajnë shumë mirë. 7. Kjo gazetare raporton një aksident tani.

1. Ç'kombësi ka ajo? 2. Ç'profesion ka ai? 3. Ç'gjuhë flet Pamela? 4. Çfarë kombësie ka ajo? Është shqiptare. 5. Çfarë profesioni ka ai? 6. Çfarë gjuhe flet Pamela? 7. Ne bëjmë shëtitje në park çdo ditë. 8. Sara vjen nga kopshti në orën katër.

Ushtrimi 6.5

1. Nga jeni? 2. Çfarë jeni? 3. Sa vjeç jeni? 4. Ku po studioni shqip? 5. Ku jetoni? 6. Ç'gjuhë flisni? 7. Kur studioni shqip? 8. Kur fillon dhe mbaron mësimi? 9. Ç'bën të shtunën? 10. Ke vëlla ose motër?

Ushtrimi 6.6

1. Ku është thika? Është mbi tryezë. Po gota, ku është? Është në kuzhinë. Ku është kuzhina? 2. Ç'ka në dhomë? Ka një kolltuk, një televizor dhe një tryezë. Ku është kolltuku? Është majtas, kurse televizori dhe tryeza janë djathtas. A ka një libër në dhomë? Po, libri është mbi tryezë. Si është dhoma? 3. Ç'bën burri yt? Është mësues. Po gruaja jote? Është dentiste. A ke fëmijë? Po, kam një djalë. Sa vjeç është djali? Është 10 vjeç. Po ti, a ke fëmijë? Po, kam një vajzë. Sa vjeçe është vajza? Edhe ajo është 10 vjeçe. 4. A shkojmë në park? Ku është kinemaja? Nuk është shumë larg. 5. Gjyshja po gatuan dhe gjyshi po shikon televizor. Motra ime është në universitet, kurse vëllai im është në shtëpi. Tani po luan në oborr me një shok. Shoku quhet Ardian.

Ushtrimi 6.7

1. Ky fjalor është shumë i shtrenjtë. Ky fjalor është shumë i lirë. 2. Dyqani është i mbyllur. Dyqani është i hapur. 3. Mësuesja është e lumtur. Mësuesja është e trishtuar. 4. Studentja është shqiptare. Studentja është e huaj. 5. Nëna ime është e sëmurë. Nëna ime është e shëndetshme. 6. Sokoli është i zgjuar. Sokoli është budalla. 7. Kutia është e vogël. Kutia është e madhe. 8. Kjo revistë është shumë e keqe. Kjo revistë është shumë e mirë. 9. Kompjuteri është i ri. Kompjuteri është i vjetër. 10. Gruaja është e re. Gruaja është e vjetër.

Ushtrimi 6.8

1. Ku janë kutia e kuqe dhe lapsi i zi? 2. Dhoma është e lirë, por mëngjesi është pak i shtrenjtë. 3. Kjo revistë është shumë e shtrenjtë. Kjo gazetë, nga ana tjetër, është e lirë. 4. Mësuesja është e zënë sot, por mësuesi është i lirë. 5. Fjalori është shumë i nevojshëm për ne. 6. A është i shtrenjtë ai fjalor? 7. Gjyshi është i lumtur, por gjyshja është e trishtuar. 8. Ky klient është i kënaqur, kurse ai klient është i pakënaqur. 9. Lulja e madhe është e gjelbër, kurse lulja e vogël është e verdhë. 10. Lapsi i zi është mbi tryezë dhe fletorja e zezë është mbi karrige. Edhe fjalori është mbi tryezë.

Mësimi 7

Ushtrimi 7.2

Singular Indefinite	Singular Definite	Plural Indefinite	Plural Definite
student	studenti	studentë	studentët
gabim	gabimi	gabime	gabimet
qytet	qyteti	qytete	qytetet
tekst	teksti	tekste	tekstet

mendim	mendimi	mendime	mendimet
emision	emisioni	emisione	emisionet
film	filmi	filma	filmat
përkthyes	përkthyesi	përkthyes	përkthyesit
studiues	studiuesi	studiues	studiuesit
ushtrim	ushtrimi	ushtrime	ushtrimet

Ushtrimi 7.3

1. Këta mësues janë nga Tirana. 2. Në bëjmë disa ushtrime në fletore. 3. Ju shihni një shok/ disa shokë. 4. Kemi disa takime nesër. 5. Ata flasin me disa burra. 6. Mësuesit shpjegojnë. 7. Baballarët po flasin me disa djem. 8. Ekonomistët bisedojnë me disa gazetarë. 9. Vëllezërit po luajnë në oborr. 10. Këtu ka disa studentë. 11. Ata po lexojnë disa libra. 12. Lapsat janë mbi tryezë. 13. Universitetet janë larg. 14. Këto mësimë janë interesante. 15. Librat janë mbi tryezë. 16. A shihni ju filma shqiptarë? 17. Djemtë po mësojnë në shtëpi. 18. Burrat po lexojnë disa libra. 19. Ku janë vëllezërit? 20. Përkthyesit po përkthejnë disa libra.

Ushtrimi 7.4

1. Mësuesit lexojnë tekste interesante. 2. Mësuesit amerikanë po mësojnë shqip. 3. Mësuesit shqiptarë shpjegojnë në klasë. 4. Bëjmë shumë gabime kur flasim, sepse jemi studentë fillestarë. 5. Lexojmë artikuj interesantë. 6. Këta janë shkrimtarë grekë. 7. Lexojmë shpesh tekste shkencore. 8. Flasim shpesh me italianë. 9. Amerikanët punojnë shumë. 10. Pirunët janë francezë. 11. Mjeku japonez punon në spitalet amerikane. 12. Po ftoj disa shokë slovenë dhe kroatë në festë. 13. Në universitet ka studentë zviceranë. Ata flasin anglisht shumë mirë.

Ushtrimi 7.6

1. Qyteti është i madh dhe i bukur. Qytetet janë të mëdha dhe të bukura. 2. Rruga është e zhurmshme. Rrugët janë të zhurmshme. 3. Dimri është i ftohtë. Dimrat janë të ftohtë. 4. Dita është e gjatë. Ditët janë të gjata. 5. Shtëpia është e qetë. Shtëpitë janë të qeta. 6. Nata është e bukur dhe pak e trishtuar. Netët janë të bukura dhe pak të trishtuara. 7. Djali është shqiptar, kurse vajza është e huaj. Djemtë janë shqiptarë, kurse vajzat janë të huaja. 8. Shkolla është e mbyllur të dielën. Shkollat janë të mbyllura të dielën. 9. Mësuesi është i lumtur, kurse mësuesja është e trishtuar. Mësuesit janë të lumtur, kurse mësueset janë të trishtuara. 10. Kjo valixhe është e lehtë. Ajo valixhe është shumë e rëndë. Këto valixhe janë të lehta. Ato valixhe janë shumë të rënda. 11. Ky djalë është shumë i zgjuar. Këta djem janë shumë të zgjuar. 12. Kjo vajzë është shumë e zgjuar. Këto vajza janë shumë të zgjuara. 13. Tryeza nuk është e zezë, por e kaltër. Tryezat nuk janë të zeza, por të kaltra. 14. Libri i ri është këtu, por ku është revista e re? Librat e rinj janë këtu, por ku janë revistat e reja? 15. Kjo vajzë është e vogël. Ajo vajzë është e madhe. Këto vajza janë të vogla. Ato vajza janë të mëdha.

Ushtrimi 7.7

1. Kjo gazetë është shumë e mirë. Këto gazeta janë shumë të mira. Këto gazeta janë shumë të këqija. 2. Autobusi është i lirë. Autobusët janë të lirë. Autobusët janë të shtrenjtë. 3. Televizori është i madh. Televizorët janë të mëdhenj. Televizorët janë të vegjël. 4. Radioja është e zezë. Radiot janë të zeza. Radiot janë të bardha. 5. Klienti është i kënaqur. Klientët janë të kënaqur. Klientët janë të pakënaqur. 6. Kjo valixhe është pak e rëndë. Këto valixhe janë pak të rënda. Këto valixhe janë pak të lehta. 7. Ky mësim është i lehtë. Këto mësimë janë të lehta. Këto mësimë janë të vështira. 8. Mjeku është i zënë sot. Mjekët janë të zënë sot. Mjekët janë të lirë sot. 9. Ky fjalor është shumë i shtrenjtë. Këta fjalorë janë shumë të shtrenjtë. Këta fjalorë janë shumë të lirë. 10. Dyqani është i mbyllur. Dyqanet janë të mbyllura. Dyqanet janë të hapura. 11. Mësuesja është e lumtur. Mësueset janë të lumtura. Mësueset janë të trishtuara. 12. Avokati është shqiptar. Avokatët janë shqiptarë. Avokatët janë të huaj. 13. Studenti është i sëmurë. Studentët janë të sëmurë. Studentët janë të shëndetshëm. 14. Vajza është e zgjuar. Vajzat janë të zgjuara. Vajzat janë budallaqe. 15. Kutia është e vogël. Kutitë janë të vogla. Kutitë janë të mëdha. 16. Kjo revistë është shumë e keqe. Këto revista janë shumë të këqija. Këto

revista janë shumë të mira. 17. Kompjuteri është i ri. Kompjuterët janë të rinj. Kompjuterët janë të vjetër. 18. Vajza është e vogël. Vajzat janë të vogla. Vajzat janë të mëdha. 19. Libri është i zi. Librat janë të zinj. Librat janë të bardhë. 20. Fjalori është i vogël. Fjalorët janë të vegjël. Fjalorët janë të mëdhenj.

Ushtrimi 7.8

1. Diskoteka e re është e hapur, kurse diskoteka e vjetër është e mbyllur. Diskotekat e reja janë të hapura, kurse diskotekat e vjetra janë të mbyllura. 2. Gazeta e sotme është në tryezë. Gazetat e sotme janë në tryezë. 3. Tryeza është e kuqe. Tryezat janë të kuqe. 4. Këtu është biçikleta e madhe. Ku është biçikleta e vogël? Këtu janë biçikletat e mëdha. Ku janë biçikletat e vogla? 5. Vajza është e gjatë, kurse djali është i shkurtër. Vajzat janë të gjata, kurse djemtë janë të shkurtër. 6. Dhoma është e lirë. Dhomat janë të lira. 7. Në dimër, dita është e shkurtër dhe nata është e gjatë. Në dimër, ditët janë të shkurtra dhe netët janë të gjata. 8. Vajza e vogël dhe djali i madh banojnë këtu. Vajzat e vogla dhe djemtë e mëdhenj banojnë këtu. 9. Ky ushtrim është i lehtë, kurse ai është i vështirë. Këto ushtrime janë të lehta, kurse ato janë të vështira. 10. Fletorja është e re. Edhe libri është i ri. Fletoret janë të reja. Edhe librat janë të rinj. 11. Studenti është i sëmurë, kurse mësuesja është e shëndetshme. Studentët janë të sëmurë, kurse mësueset janë të shëndetshme. 12. Apartamenti është i vogël. Edhe shtëpia është e vogël. Apartamentet janë të vogla. Edhe shtëpitë janë të vogla. 13. Ku janë kutia e kuqe dhe lapsi i zi? Ku janë kutitë e kuqe dhe lapsat e zinj? 14. Mësuesja është e zënë sot, por mësuesi është i lirë. Mësueset janë të zëna sot, por mësuesit janë të lirë. 15. Hoteli i madh është larg, kurse hoteli i vogël është afër. Hotelet e mëdha janë larg, kurse hotelet e vogla janë afër. 16. Fjalori është shumë i nevojshëm në këtë klasë. Fjalorët janë shumë të nevojshëm në këtë klasë. 17. Lapsi i zi është mbi tryezë dhe fletorja e kuqe është mbi karrige. Lapsat e zinj janë mbi tryezë dhe fletoret e kuqe janë mbi karrige. 18. Gjyshi është i lumtur, por gjyshja është e trishtuar. Gjyshërit janë të lumtur, por gjyshet janë të trishtuara. 19. Ky klient është i kënaqur, kurse ai klient është i pakënaqur. Këta klientë janë të kënaqur, kurse ata klientë janë të pakënaqur. 20. Lulja e madhe është e gjelbër, kurse lulja e vogël është e verdhë. Lulet e mëdha janë të gjelbra, kurse lulet e vogla janë të verdha.

Ushtrimi 7.9

Tirana është një qytet i madh dhe i bukur. Në Tiranë ka shumë ndërtesa të reja dhe të vjetra. Ndërtesat e reja janë të larta dhe moderne, kurse ndërtesat e vjetra janë kryesisht të ulëta dhe me ngjyra të forta. Në ditët e sotme, Tirana është një qytet plot me hotele, restorante, bare dhe kafene. Tirana ka në qendër një shesh të madh dhe të bukur. Ky është sheshi 'Skënderbej'. Atje ndodhen Muzeu Historik Kombëtar, Pallati i Kulturës, Hotel 'Tirana', Xhamia e Ethem Beut, Kulla e Sahatit. Kulla e Sahatit është 35 metra e lartë. Kulla është e hapur për turistët. Nga kjo kullë turistët shohin pamje shumë të bukura. Muzeu Historik Kombëtar është një muze shumë i rëndësishëm dhe me shumë objekte historike. Në Tiranë ka disa kisha dhe xhami. Teatri i Operës dhe i Baletit, Teatri Kombëtar, Galeria e Arteve etj., janë qendra të rëndësishme kulturore. Në Tiranë ka universitete publike dhe disa universitete private. Tirana ka klimë të mirë. Dimri është i shkurtër dhe i butë. Temperaturat në dimër nuk janë shumë të ulëta. Kurse vera është e nxehtë dhe me temperatura të larta.

Ushtrimi 7.10

See Ushtrimi 7.9 above.

Mësimi 8

Ushtrimi 8.1

Bojkeni po del nga zyra. Eanda është në shtëpi. Ajo po gatuan për darkë dhe ka nevojë për disa gjëra. Ajo po përgatit një ëmbëlsirë me mjaltë dhe me arra por ka pak arra. Eanda do kilogramë miell. Bojkeni shkon në dyqan. Dyqani mbyll për një orë. Ai ka kohë. Eanda do dhe treqind gramë bajame dhe dyqind gramë lajthi. Bojkeni merr kafe dhe kakao. Ai nuk merr çaj. Ai blen makarona dhe oriz. Ai blen kripë dhe dy litra vaj ulliri.

Ushtrimi 8.2

1. Nga po del tani? 2. Çfarë po bën? 3. Çfarë do? 4. Në ç'orë mbyllin dyqanet? 5. A kemi kuti me çaj? 6. A kemi mjaltë? 7. Cilat makarona janë më të mira? 8. A kemi oriz?

Ushtrimi 8.3

1. Pse po hapni dritaret? Jo, ne nuk po hapim dritaret, po hapim dyert. 2. Çfarë po përgatit tani? Po përgatis një ëmbëlsirë. 3. Ç'po bën Besa tani? Ajo po shëtit në park, kurse burri i saj po gatuan për darkë. 4. Pse po mbyllni dritaret? Sepse kemi pak ftohtë. 5. Në ç'orë del nga shtëpia? Zakonisht dal në orën 7. Në ç'orë del ti dhe burri yt? Ne dalim në orën 6:25. 6. Ç'po masin ata? Ata po masin ballkonet. 7. Për çfarë po pret ti? Po pres një telefonatë. 8. A po përgatit ajo makarona për darkë? Jo, ajo nuk po përgatit makarona. 9. Çfarë bëjnë ata pasdite? Ata shëtisin në park. 10. Unë po mas një tryezë. Po ju çfarë po masni? Ne po masim një dhomë.

Ushtrimi 8.4

	hap	përgatis	dal	mbyll	shëtis	marr
ti	hap	përgatit	del	mbyll	shëtit	merr
ju	hapni	përgatisni/përgatitni	dilni	mbyllni	shëtisni/shëtitni	merrni
ai, ajo	hap	përgatit	del	mbyll	shëtit	merr
unë	hap	përgatis/përgatit	dal	mbyll	shëtis/shëtit	marr
ne	hapim	përgatisim/përgatitim	dalim	mbyllim	shëtisim/shëtitim	marrim
ata, ato	hapin	përgatisin/përgatitin	dalin	mbyllin	shëtisin/shëtitin	marrin

Ushtrimi 8.5

1. Tirana është më e madhe se Saranda. 2. Kjo rrugë është më e zhurshme se ajo. 3. Pranvera është stina më e bukur nga të gjitha. 4. Dimri është më i ftohtë se vjeshta. 5. Dita më e gjatë është 21 qershori. 6. Këta djem janë më të zgjuar se ata. 7. Besa dhe Tina janë më të vogla se Dona. 8. Ky libër është më i mirë se ai, por është më i shtrenjtë. 9. Megjithëse këto shtëpi janë aq të mëdha sa ato, ato janë më të lira. 10. Këta janë librat më të rinj. 11. Ato janë valixhet më të rënda. 12. Këto janë revistat më të këqija. 13. Cili është studenti më i mirë? 14. Cilët janë studentët më të vjetër? 15. Një kilogram sheqer është më i shtrenjtë se një kilogram kripë. 16. Çaji është më i lirë se kafeja?

Ushtrimi 8.6

1. Kjo makinë është më e shpejtë se makina ime. 2. Ato makina janë më të shpejta nga të gjitha. 3. Këta studentë janë më të zgjuar se ata. 4. Këto ushtrime janë më të vështira se ato. 5. Ajo rrugë është rruga më e zhurshme nga të gjitha rrugët në qytet. 6. Kafja në Itali është më e fortë se kafja më Shqipëri. 7. Netët janë më të freskëta se ditët. 8. Këta kolltukë janë më të këndshëm se ata. 9. Këto kliente janë më të kënaqura se ato. 10. Ajkuna është më rëndësishme se Besa. 11. Motra ime është më e suksesshme se vëllai im. 12. Këta libra janë më të rinj se ata. 13. Këto ndërtesa janë më të larta se ato. 14. Këto dardha janë më të shijshme se ato. 15. Kripa është më e shtrenjtë se sheqeri.

Ushtrimi 8.8

1. Studenti do të këndoje në klasë. 2. A do të pushosh apo do të punosh nesër? 3. A mund të shkruash një letër? 4. Ajo nuk mund të marrë në telefon. 5. Shitësi duhet të zgjedhë fruta dhe perime. 6. Vajza do të përgatisë një ëmbëlsirë. 7. Është e rëndësishme të presim shokët. 8. A mund të presësh një minutë? Artani duhet të jetë i zënë tani. Do të vijë pas pak. 9. Në ç'orë shkon të notosh çdo ditë? 10. Të shtunën, Gëzimi do të shkojë në kinema që të shohë një film shqiptar. 11. Unë mendoj që është mirë të thuash çfarë mendon. 12. Sokoli do të udhëtojë për në Kinë, pasi të mbarojë studimet. 13. Para se të shohësh këtë film, ti duhet të lexosh këta artikuj. 14. A mund të vraposh si Dita? 15. Kur duhet të mbyll dyqanet?

Ushtrimi 8.9

1. Dua të blej perime të freskëta. 2. Ana do të marrë qershi. 3. Ti mund të marrësh qershi. 4. Po shkoj të pyes prindërit. 5. Ato duan të shohin një film shqiptar. 6. Ne duhet të lexojmë libra të rinj. 7. Është mirë të pyesim në disa dyqane për gjërat që duam. 8. Unë po shkoj të shoh atë dyqan. 9. Dua të dal me shokët dhe shoqet. 10. Mund të përgatisim darkë. 11. Po vij dhe unë që të zgjedhim librat. 12. Ato po shkojnë që të flasin me djemtë.

Ushtrimi 8.10

1. Ata po lexojnë disa libra të rinj. Ata do të lexojnë disa libra të rinj. 2. Unë po flas në telefon me një shoqe. Unë do të flas në telefon me një shoqe. 3. Djemtë po blejnë disa gazeta. Djemtë do të blejnë disa gazeta. 4. Ata po diskutojnë për disa probleme. Ata do të diskutojnë për disa probleme. 5. Vajzat po dalin nga shtëpia dhe po shkojnë në shkollë. Vajzat do të dalin nga shtëpia dhe do të shkojnë në shkollë. 6. Vera është e ngrohtë. Vera do të jetë e ngrohtë. 7. Nuk (po) kuptoj se çfarë (po) ndodh (to happen). Nuk do të kuptoj se çfarë do të ndodhë. 8. Studentet (po) hyjnë në mësim dhe (po) flasin me zë të lartë. Studentet do të hyjnë në mësim dhe do të flasin me zë të lartë. 9. Ne kemi shumë punë. Ne do të kemi shumë punë. 10. Ai nuk ka shumë kohë. Ai nuk do të ketë shumë kohë. 11. Besa sheh televizor dhe këndon. Besa do të shohë televizor dhe do të këndojë. 12. Ju merrni në telefon. Ju do të merrni në telefon. 13. Ajo (po) pret një shoqe. Ajo do të presë një shoqe. 14. Nëna (po) lan frutat dhe (po) përgatit një sallatë. Nëna do të lajë frutat dhe do të përgatisë një sallatë. 15. (Po) dëgjoni një këngë. Do të dëgjoni një këngë. 16. Ajo (po) flet me një djalë. Ajo do të flasë me një djalë. 17. Ne po shëtisim në qytet. Ne do të shëtisim në qytet. 18. Koncerti është në orën 15:00. Koncerti do të jetë në orën 15:00. 19. Ditët janë të gjata. Ditët do të jenë të gjata. 20. Ti po mbyll dritaret. Ti do të mbyllësh dritaret. 21. Ju po jepni një detyrë. Ju do të jepni një detyrë. 22. Sot kam shumë punë. Sot do të kem shumë punë. 23. Sportistët po luajnë shumë bukur. Sportistët do të luajnë shumë bukur. 24. Këngëtarët po japin një koncert. Këngëtarët do të japin një koncert. 25. Ata po mbyllin dyert. Ata do të mbyllin dyert. 26. Prindërit po presin. Prindërit do të presin. 27. Ai po përkthen një artikull. Ai do të përkthejë një artikull. 28. Ajo po sheh në televizor një film italian. Ajo do të shohë në televizor një film italian. 29. Studentet po vijnë në klasë. Studentet do të vijnë në klasë. 30. Ajo po gatuan tani. Ajo do të gatujë tani.

Ushtrimi 8.12

Një dietë e shëndetshme dhe e rregullt është shumë e rëndësishme për njerëzit. Frutat, perimet e freskëta dhe drithërat duhet të jenë çdo ditë në tryezë. Njerëzit e shëndetshëm duhet të konsumojnë katër deri në gjashtë gota ujë në ditë. Mjekët thonë se një dietë e mirë duhet të ketë vitamina dhe kripëra minerale që janë shumë të nevojshme. Në dimër, mjekët këshillojnë që të përdorim sa më shumë perime dhe fruta të freskëta që kanë vitamina A dhe C, si: mandarinat, kivi, spinaqi, kungulli dhe karotat. Duhet të konsumojmë dhe produkte që kanë vitaminë E si: gruri, bajamet, arrat, patatet dhe lajthitë. Në verë është mirë të konsumojmë shumë perime dhe fruta, sepse kanë ujë. Zgjedhje e mirë janë frutat e freskëta, si shalqiri dhe pjepri, perimet si domatet, sallata jeshile dhe brokoli. Në situata stresi mjekët këshillojnë një dietë me bukë, makarona, oriz, sallatë jeshile, qepë, djathë, kos, vezë dhe qumësht. Frutat e ëmbla dhe mjalti ndihmojnë që të jemi të qetë. Në këto situata është mirë të mos përdorim kafe, çaj, kakao apo çokollata. Edhe ushqimet pikante me piper, apo me shumë kripë, si dhe alkooli janë shumë të dëmshme.

Ushtrimi 8.13

Një dietë e shëndetshme dhe e rregullt është shumë e rëndësishme për njerëzit. Frutat, perimet e freskëta dhe drithërat duhet të jenë çdo ditë në tryezë. Njerëzit e shëndetshëm duhet të konsumojnë katër deri në gjashtë gota ujë në ditë. Mjekët thonë se një dietë e mirë duhet të ketë vitamina dhe kripëra minerale që janë shumë të nevojshme. Në dimër, mjekët këshillojnë që të përdorim sa më shumë perime dhe fruta të freskëta që kanë vitamina A dhe C, si: mandarina, kivi, spinaqi, kungulli dhe karota. Duhet të konsumojmë dhe produkte që kanë vitaminë E si: gruri, bajamet, arrat, patatet dhe lajthitë. Në verë është mirë të konsumojmë shumë perime dhe fruta, sepse kanë ujë. Zgjedhje e mirë janë frutat e freskëta, si shalqiri dhe pjepri, perimet si domatet, sallata jeshile dhe brokoli. Në situata stresi mjekët këshillojnë një dietë me bukë, makarona, oriz, sallatë jeshile,

qepë, djathë, kos, vezë dhe qumësht. Frutat e ëmbla dhe mjalti ndihmojnë që të jemi të qetë. Në këto situata është mirë të mos përdorim kafe, çaj, kakao apo çokollata. Edhe ushqime pikante me piper, apo me shumë kripë, si dhe alkooli janë shumë të dëmshme.

Mësimi 9

Ushtrimi 9.2

Agjencinë, agjencia, banor, Tiranë, apartament, gazetën, agjencia, oferta, çmime, këto, oferta, cilat, kërkesat, dhoma, kuzhinë, apartamente, apartamente, rrugën, apartamente, rrugën, rrugën, apartament, atë, çmimi, këtë, çmimin, pyetje, ballkoni, këtë, apartamentin, ditë, agjencia, punë, apartamentin, orë, orën, atë, orën, ndihmën, kënaqësia.

Ushtrimi 9.3

1. Cilat agjenci janë italiane? Ka disa agjenci italiane. 2. Sapo dalin nga shkolla, këta mësues dhe studentë shkojnë në muze. 3. Këta nxënës janë 10 vjeç. Unë mësoj me këta nxënës në shkollën amerikane. 4. Nuk marrim një apartament me qira tani. Për këtë po presim një ofertë. 5. Me këtë gazetare kosovare komunikojmë vazhdimisht. Ajo jep informacion për publikun. 6. Pa këtë informacion nuk vazhdojmë dot këtë takim. 7. Ky informacion nuk është me rëndësi për atë mjek.

Ushtrimi 9.5

Teke, dyshe, të lira, të lira, mirë, të mëdha, komode, e interesuar, i lartë, teke, teke, teke, e dhjetë, dyshe, e tetë, e përfshirë, të mirë, e interesuar, shumë të bukur, e parë, shumë të mirë, të fundit, e saktë, e nevojshëm.

Ushtrimi 9.6

1. Kam një pyetje. Po! Ç' do? Çfarë po pi? Po pi ujë! Pse pi aq shpejt? Sepse kam etje! 2. Kemi një pyetje. Po! Ç' doni? Çfarë po hani? Po hamë bukë! Pse hani aq shpejt? Sepse kemi uri! 3. A flisni ju shqip? Pak, tani po mësojmë shqip në universitet. Kur keni mësim? Kemi mësim çdo ditë. Sa orë është mësimi? Gjashtëdhjetë minuta. Nga është mësuesi? Është nga Shqipëria. Shpjegon mirë? Po, shpjegon shumë mirë. Ne po mësojmë shumë në klasë. 4. Ku po shkoni? Shkojmë në shkollë. Në shkollë? A keni mësim sot? Po, kemi mësim çdo pasdite. Shkolla është larg? Jo, vetëm pesë minuta më këmbë. 5. Çfarë po blen ti? Po blej një gazetë. Ç' gazetë do të blesh? Dua të blej 'Gazetën shqiptare'. 6. Ç' do të pish për mëngjes? Dua të pi çaj dhe lëng frutash. Ç' do të hash? Dua të ha vetëm bukë me gjalpë. Po ti, ç' do të pish? Unë dua të pi kafe me qumësht. Dhe çfarë do të hash ti? Dua të ha një çokollatë, kur të kem kohë.

Ushtrimi 9.7

Ema do të rezervojë një dhomë teke dhe një dhomë dyshe për datat 10–15 tetor. Ajo pyet në hotel nëse kanë dhoma të lira në ato data. Ajo bisedon me receptionisten dhe bën rezervimin. Në datat 10–15 tetor ka dhoma të lira. Dhomat janë të mëdha dhe shumë komode. Ema do të rrijë në katin e dhjetë. Hoteli ka dhe një restorant. Restoranti është shumë i mirë. Ajo do të hajë drekë në një verandë të bukur. Në hotel ka dhe një kafene shumë të mirë, ku ajo do të pijë kafe.

Mësimi 10

Ushtrimi 10.1

1. Në Republikën e Shqipërisë ka disa festa zyrtare. 2. Dita e Sulltan Novruzit është festa e bektashinjve. 3. Më 14 Mars ne festojmë Ditën e Verës. 4. Ajo simbolizon largimin e dimrit dhe ardhjen e pranverës. 5. Dita e Pavarësisë është më 28 Nëntor. 6. Më 29 Nëntor festojmë Ditën e Çlirimit. 7. Emri i vërtetë i Nënë Terezës është Gonxhe Bojaxhi. 8. Më 19 Tetor është Dita e Lumturimit të Nënë Terezës. 9. Më datën 1 Maj festojmë Ditën e Punëtorëve. 10. Kemi disa ditë përkujtimore: si 5 Majin, Dita e Dëshmorëve; 1 Qershorin, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve.

Ushtrimi 10.2

1. Po bëj detyrën e shtëpisë. Po bëj detyrat e shtëpisë. 2. Po bisedoj me klienten e lokalit. Po bisedoj me klientet e lokalit. 3. Programi i kompjuterit është i vështirë. Programet e kompjuterit janë të vështira. 4. Po presim letrën e shoqes. Po presim letrat e shoqes. 5. Qiraja e shtëpisë është e lartë. Qiratë e shtëpive janë të larta. 6. Unë shikoj sekretaren e shkollës. Unë po shikoj sekretaret e shkollës. 7. Po bisedojmë me drejtuesin e universitetit. Po bisedojmë me drejtuesit e universitetit. 8. Dita e Verës është shumë e bukur. Ditët e verës janë të bukura. 9. Festa e shkollës është e veçantë. Festat e shkollës janë të veçanta. 10. Mësuesi po hap dritaren e dhomës. Mësuesit po hapin dritaret e dhomës.

Ushtrimi 10.3

1. Në Republikën e Shqipërisë ka disa festa zyrtare. 2. Dita e Novruzit ose Dita e Sulltan Novruzit është festa e bektashinjve. 3. Më 14 Mars ne festojmë Ditën e Verës. 4. Ajo simbolizon largimin e dimrit dhe afrimin e pranverës. 5. Kjo është një festë tradicionale sidomos për qytetin e Elbasanit. 6. Dita e Pavarësisë është më 28 Nëntor. 7. Më 29 Nëntor festojmë Ditën e Çlirimit. 8. Më datën 1 Maj festojmë Ditën e Punëtorëve. 9. Emri i vërtetë i Nënë Terezës është Gonxhe Bojaxhi. 10. Pesë Maji është Dita e Dëshmorëve. 11. Dita e Mësuesit është më 7 Mars. 12. Tetë Marsi është Dita Ndërkombëtare e Gruas. 13. Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve është më 1 Qershor.

Ushtrimi 10.4

1. Kjo është macja e Dardanit. 2. Studentët mësojnë në shkollën e qytetit. 3. Më falni, ku është stacioni i trenit i qytetit? 4. Ku është makina e nënës së Besnikut? 5. Vajza e shokut të Sokolit është mësuese. 6. I kujt është ky libër? I Anës. 7. Shoku im banon në qytetin e Sarandës. 8. Shumica e studentëve në Shqipëri flasin italisht. 9. Prindërit e Verës janë të rinj. 10. Makina e zezë është e Zamirit. 11. Ata janë disa shokë të shkollës. 12. Mësuesja e letërsisë është e martuar. 13. Burri i mësueses së letërsisë quhet Artan. 14. Ku janë çelësat e dhomës? Mbi tryezën e vogël. 15. Fjalori i kujt është ky? Ky është fjalori i studentëve të huaj. 16. Të kujt janë këto valixhe të kuqe? Këto valixhe të kuqe janë të studentes së huaj që banon në këtë konvikt. 17. Ku banojnë studentët universitarë në Shtetet e Bashkuara? Në qytetin e studentëve. Dhomat janë më të lira dhe më të rehatshme. 18. Shoqja e vajzës së zgjuar studion në Mbretërinë e Bashkuar. 19. Klasa e mësueses së anglishtes është e madhe, kurse klasa e mësueses së italishtes është e vogël. 20. Gjysma e klasës lexon një kapitull të librit çdo ditë. 21. Disa shokë të sekretares së zyrës vijnë në festë sonte. 22. Duam dy gota verë të kuqe. 23. Shërbimi i kamarierit në këtë kafene është shumë i keq. 24. Ku është çanta e nënës së Agimit? Në dhomën e Besnikut. 25. Ku është çanta e zezë e nënës së Agimit? Në dhomën e vogël të Besnikut.

Ushtrimi 10.5

Në Teatrin e Operës dhe të Baletit ka një shfaqje shumë të bukur. Ansambli i Këngëve dhe i Valleve Popullore hap sezonin e ri me një koncert me këngë e valle popullore. Koncerti fillon në orën 20:00 dhe mbaron në orën 22:00. Në akademinë e Arteve të Bukura ka një koncert recital. Në Teatrin Kombëtar ka një shfaqje të re të një dramaturgu rumun. Në Galerinë e Arteve është përrurimi i një ekspozite pikturë. Edhe në Muzeun Historik Kombëtar ka një ekspozitë të përbashkët të disa artistëve të njohur.

Ushtrimi 10.6

1. Kjo është fletorja e një vajze. Këto janë fletoret e disa vajzave. Unë shikoj fletoren e një vajze. Unë shikoj fletoret e disa vajzave. 2. Macja është e atij djali. Macet janë të atyre djemve. Unë shikoj macen e atij djali. Unë shikoj macet e atyre djemve. 3. Çanta është e kësaj gruaje. Çantat janë të këtyre grave. Unë shikoj çantën e kësaj gruaje. Unë shikoj çantat e këtyre grave. 4. Libri është i atij burri. Librat janë të atyre burrave. Unë shikoj librin e atij burri. Unë shikoj librat e atyre burrave. 5. Kënga është e asaj kompozitoreje. Këngët janë të atyre kompozitoreve. Unë dëgjoj këngën e asaj kompozitoreje. Unë dëgjoj këngët e atyre kompozitoreve.

Ushtrimi 10.7

1. Ç'aktivitete ka sot në Tiranë? Në Tiranë ka sot disa aktivitete. 2. Ç'shfaqje ka në Teatrin e Operës dhe të Baletit? Në Teatrin e Operës dhe të Baletit ka një shfaqje shumë të bukur. 3. Çfarë ka në program? Në program ka këngë e valle të shumë trevave shqiptare. 4. A ka ndonjë koncert tjetër pasdite? Po, në Akademinë e Arteve të Bukura ka një koncert recital. 5. I kujt është koncerti recital? Koncerti recital është i një pianisteje shqiptare. 6. Kur fillon Festivali i Këngës në Pallatin e Kongreseve? Festivali i Këngës në Pallatin e Kongreseve fillon nesër në mbrëmje. 7. Çfarë ka sonte në Teatrin Kombëtar? Ka një shfaqje të re. 8. Çfarë aktiviteti ka në Galerinë e Arteve? Në Galerinë e Arteve sot pasdite është përurimi i një ekspozite piktore. 9. Të kujt janë punimet? Punimet janë të disa piktorëve shkodranë. 10. Çfarë aktiviteti ka në Muzeun Historik Kombëtar? Në Muzeun Historik Kombëtar ka një ekspozitë të përbashkët të disa artistëve të njohur. 11. Muzika e kësaj kënge është shumë e bukur. 12. I kujt është ai punim? Është i atij dramaturgut francez shumë të njohur. 13. Ky libër është shumë interesant! I cilës shkrimtareje është? I një shkrimtareje shqiptare. 14. Në ç'orë fillon kjo shfaqje? Në orën nëntë. Cilët aktorë luajnë? Në këtë shfaqje ka vetëm gra, nuk ka burra. Cilat aktore janë në shfaqje? Janë aktore shumë të njohura. 15. Të kujt janë këto fletore? Të atyre mësuesve. Po këta libra? Të asaj mësueseje.

Ushtrimi 10.8

1. Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës është një aktivitet i një rëndësie të veçantë. 2. Kalaja e Gjirokastrës pret një herë në katër vjet grupe folklorike. 3. Qyteti i Gjirokastrës, në ditët e Festivalit Folklorik ka shumë vizitorë shqiptarë dhe të huaj. 4. Ky festival dëshmon se folklori muzikor është i pasur dhe i larmishëm. 5. Këngët kanë forma të ndryshme të interpretimit. 6. Në Jug të vendit është karakteristike isopolifonia që tani dhe është pjesë e trashëgimisë orale të njerëzimit. 7. Instrumente muzikore, si lahuta, çiftelja, sharkia dhe daullja shoqërojnë këngët dhe vallet. 8. Pjesë e rëndësishme e festivalit janë vallet. 9. Valle të famshme janë vallja e Rugovës, vallja e Tropojës, e Devollit, e Lunxhërisë, vallja e Rrajcës, vallet labe si dhe vallja çame e Osman Tagës.

Mësimi 11

Ushtrimi 11.2

